



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice**

---

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 13/2013 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë publikon:

**SHPALLJEN PËR APLIKIM**  
**PËR DHËNIEN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS**

Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar, të cilët dëshirojnë që të aplikojnë për dhënien e Provimit të Jurisprudencës që do të mbahet ne **muajin Maj 2022**, se:  
Afati për dorëzimin e Kërkesës dhe dokumentacionin përkatës për dhënien Provimit të Jurisprudencës fillon prej datës **19 Prill 2022 deri me 22 Prill 2022.**

**I.** Kërkesës për dhënien e Provimit të Jurisprudencës e cila merret në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, duhet t'i bashkëngjisni dokumentet e **vërtetuara te Noteri** me të cilat dëshmohet se i plotëson kushtet ligjore, si në vijim:

1.Kërkesën për dhënien e Provimit të Jurisprudencës, e cila mund të sigurohet duke e shkarkuar ne këtë link <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,43>

2.Diplomën e Fakultetit Juridik, sipas programit katërvjeçar ose studimet master. Kandidatet që dorëzojnë diplomën e studimeve Master së bashku me të duhet të bashkëngjisin edhe diplomën e studimeve themelore, e të cilat duhet të jenë kopje të Noterizuara;

3.Vërtetimin për përvojën e punës juridike pas diplomimit konform nenit 6 të Ligjit Nr. 04/l-141 për Provimin e Jurisprudencës <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,43> Vërtetimi duhet të dëshmoi përvojën e saktë të punës dhe duhet të dorëzohet origjinali apo kopje e Noterizuar;

4.Certifikatën e Shtetësisë së Republikës së Kosovës;

5.Kopjen e letërnjoftimit;

6.Nëse kandidati fakultetin e ka të përfunduar jashtë vendi, atëherë kandidati duhet ta sjell diplomën e nostrifikuar dhe Vendimin nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës. Diploma dhe Vendimi duhet të dorëzohen në kopje të Noterizuara.

Dokumentacioni i kërkuar më lart dhe i dorëzuar për lejimin e dhënies së Provimit të Jurisprudencës, nuk iu kthehet kandidatëve. Dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje, është bazë që Komisioni të refuzoj Kërkesën për lejimin e dhënies së Provimit të Jurisprudencës.

**II.** Kandidatët të cilët kanë mbetur në **riprovim** nga afati i dhjetorit 2021 duhet ta paraqesin **VETËM KËRKESËN** brenda këtij afati për t'iu nënshtruar Riprovimit në afatin e Shtatorit 2021. Kërkesën për **riprovim** mund të sigurohet në këtë link: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,43>.

**III.** Kandidatëve të cilëve me parë iu është aprovuar kërkesa për dhënien e Provimit të Jurisprudencës, e të cilët dëshirojnë t'iu nënshtrohen Provimit në këtë afat, duhet të paraqesin **VETËM KËRKESËN** për dhënien e Provimit të Jurisprudencës, e cila mund të sigurohet në këtë link: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,43>, kërkesa duhet të përmbajë të dhënat personale numrin dhe datën e Vendimit me të cilin i është mundësuar hyrja në Provim të Jurisprudencës dhe vitin në të cilin i është lejuar dhënia e Provimit të Jurisprudencës.

Kërkesa për dhënien e Provimit të Jurisprudencës dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë, Ish-Ndërtesa e Rilindjes, kati përdhese, Arkivi i Ministrisë së Drejtësisë, Prishtinë, Republika e Kosovës, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri 16:00.

Kandidatit me vendim i lejohet hyrja në Provimin e Jurisprudencës. Për vendimin, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së provimit me shkrim dhe me gojë, kandidatët do të njoftohen përmes **E-MAIL ADRESËS**, të cilën ju lutem ta shënoni qartë dhe saktë gjatë aplikimit.

**ÇDO NJOFTIM PËR PROVIMIN E JURISPRUDENCËS QË KA TE BEJ ME PUBLIKIMIN E REZULTATEVE TË PROVIMIT ËT JURISPRUDENCËS, DO TË BEHET NË FAQEN ZYRTARE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË VETËM ME NUMËR TË PROTOKOLLIT TË CILIN DO E PRANONI ME RASTIN E APLIKIMIT PËR PROVIM TË JURISPRUDENCËS NË ARKIVIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË. ANDAJ JU LUTEM QE KETË NUMËR TË PROTOKOLLIT TA PRANONI DHE TA RUANI ME QELLIM QË TË IDENTIFIKONI REZULTATIN TUAJ TË PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS KUR DO QE PUBLIKOHEN NË FAQEN ZYRTARE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË.**

Për informata të hollësishme mund të drejtoheni në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,43>.